



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec  
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIQUE DU KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/237 Nr. i faq/Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 25 / 07 / 2024

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), nenit 17, shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2024, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim, **formohet** komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, 01 Nr. 232/24, i datës 25.07.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510081-00889-0.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. **Afrim Oruqi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
  - 2.2. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
  - 2.3. **Melinda Iska**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës - PDK;
  - 2.4. **Sinan Kryeziu**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës AAK;
  - 2.5. **Vjollca Gurgule**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Anëtarëve të Komisionit ad hoc,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr.233/24  
Datë:25.07.2024

